

Të shkosh mirë me motrën ose vëllanë

«Vazhdoni të duroni dhe të falni bujarisht njëri-tjetrin, edhe nëse ndokush ka shkak për t'u ankuar kundër një tjetri.»—Kolosianëve 3:13.

Është shumë e rëndësishme të zhvillosh aftësinë për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe familja është një vend i mirë ku të fillosh.

Përdor pyetjet e mëposhtme që të dallosh, të analizosh dhe të zgjidhësh një mosmarrëveshje me motrën ose vëllanë.



DALLO PROBLEMIN

Me kë e ke më të vështirë të shkosh mirë?

Cila çështje ka më shumë të ngjarë të shkaktojë një konflikt me motrën ose vëllanë?

Si nis zakonisht mosmarrëveshja?

Motra ose vëllai . . . (përshkruaj veprimin)

kjo më bën të . . . (përshkruaj reagimin tënd)

kjo çon në . . . (përshkruaj pasojat)



Çfarë mund të mendonte motra ose vëllai gjatë mosmarrëveshjes?

ANALIZO PROBLEMIN

BIBLA THOTË:

«Duke parë me interes jo vetëm çështjet tuaja, por edhe ato të të tjerëve.» (Fili-pianëve 2:4) Me këtë në mendje, përpiqu ta shohësh mosmarrëveshjen nga këndvështrimi i motrës ose vëllait.

Sikur motra ose vëllai të tregonte historinë nga pikëpamja e tij ose e saj, ç'do të thoshte për pjesën *tënde*?

Ç'të mira sheh te pikëpamja e motrës ose e vëllait?

ZGJIDH PROBLEMIN



A ka vend për bisedime ose për kompromis? Nëse po, cili do të ishte?

Ç'mund të bësh *ti* ndryshe herën tjetër, që të mos plasë shherri për shkak të një mosmarrëveshjeje?



LISTA E PARIMEVE BIBLIKE

Cilat nga parimet e mëposhtme mund të zbatosh herën tjetër kur të kesh një konflikt të ngjashëm?

- «Kini për njëri-tjetrin dashuri të zjarrtë nga zemra.»—1 Pjetrit 1:22.
- «Arsyetueshmërinë tuaj le ta njohin të gjithë.»—Filipianëve 4:5.
- «Mos u fyej shpejt, sepse fyerja prehet në gji të budallenjve.»—Eklisiastiu 7:9.
- «Fillimi i grindjes është sikur t'u çelësh rrugë ujërave; largohu, pra, përpara se të plasë sherri.»—Proverbat 17:14.
- «Ku s'ka dru, zjarri shuhet dhe ku s'ka shpifës, grindja fashitet.»—Proverbat 26:20.
- «Pse shikon lëmishten në syrin e vëllait, dhe nuk vëren traun në syrin tënd?»—Mateu 7:3.

Në fund shkruaj një gjë që ti vlerëson te vëllai ose te motra.

ÇFARË DO TË BËJE TI?

BIBLA THOTË:

«Ka nga ata që flasin pa u menduar si me goditje shpate, por gjuha e të mençurve është shërim.»

—Proverbat 12:18.

«Kur kisha babin në spital për një kohë të gjatë, e kisha të vështirë të shkoja ta takoja, sepse nuk mund t'i jepja makinës. I tregova vëllait se doja të merrja patentën, por tha se nuk kishte kohë të më mëson-te t'i jepja makinës. Edhe pasi i shpjegova se përse më duhej, u tregua indiferent dhe pothuajse nuk ma vari fare. Më iku truri dhe i thashë se nuk i interesonte që unë nuk mund ta takoja dot babin dhe se nuk mendonte kurrë për ndjenjat e mia. Kjo e mërziti shumë. Po bërtitnim, duke akuzuar njëri-tjetrin si mospërfillës.»—*Karina*.

Po të ishe në vendin e Karinës, si do ta kishe zgjidhur *ti* këtë situatë?

ÇFARË BËRI KARINA: «Të nesërmen në mëngjes, unë dhe vëllai folëm hapur. Ai kërkoi falje që ishte mërzitur aq shumë dhe më tregoi se ishte në presion të madh. Nuk e dija se ishte aq i ngarkuar. Pasi më tregoi si ndihej vërtet, i kërkova falje që po e ngarkoja akoma më shumë. Edhe pse kisha qëllim të mirë, nuk ishte momenti për ta hapur këtë bisedë.»

